

# Mirë se vini në kantonin Valais

Udhëzues praktik për të sapoardhurit

Shërbimi i popullsisë dhe migracionit  
Zyra kantonale e integritimit  
Kantoni Valais



CANTON DU VALAIS  
KANTON WALLIS

Département de la sécurité, des institutions et du sport  
**Service de la population et des migrations**  
Departement für Sicherheit, Institutionen und Sport  
Dienststelle für Bevölkerung und Migration



# Mirësevini te ne, mirësevini te ju!

Valais, është një vend ku bashkohen bukuria e peizazheve dhe pasuria e një kulture të gjallë dhe dinamike. Këtu çdo luginë, çdo mal tregon një histori, por mbi të gjitha janë njerëzit që përbëjnë pasurinë e vendit tonë. Valais nuk është thjesht një kanton për t'u zbuluar, por është një vend ku mund të kënaqesh, ku mund të gesh një cilësi të lartë jetese në zemër të Alpeve.

Valais, një kryqëzim mes modernitetit dhe traditës. Nga njëra anë është aktor kyç në fushat më të përparura si inovacioni, kërkimi dhe sipërmarrja. Nga ana tjetër, ruan një lidhje të thellë me trashëgiminë e e vet, qoftë ajo në praktikat bujqësore, artin e të jetuarit, apo ruajtjen e festave të veta tradicionale. Kjo përzierje harmonike farketon identitetin e veçantë të kantonit tonë dhe e bën atë një vend mikpritës për të gjithë.

Valais, një tokë integrimi. Me prejardhje të ndryshme do të ftoheni të zbuloni dhe të ndani vlerat lokale, të përfshiheni plotësisht në një mjedis të ngrohtë dhe mirëdashës. Integrimi nuk përmbledhet me një përshtatje të thjeshtë, por me përvetësimin e zakoneve, ndërthurjen e lidhjeve të sinqerta dhe pasurimin e ndër-sjelltë të vazhdueshëm. Pikërisht në shumëllojshmërinë e këtyre shkëmbimeve qëndron forca reale e kantonit tonë.

Që udhëtimi juaj në Valais të jetë i suksesshëm, ju inkurajojmë të përfshiheni plotësisht në jetën lokale përmes aktiviteteve tuaja profesionale, kulturore e sociale. Mos hezitoni të takoni banorët dhe të ndihmoni në ruajtjen e pasurisë së kantonit tonë.

Valais ju ofron më tepër se një mjedis të këndshëm jetese. Ju propozon një hapësirë reale kënaqësie, shkëmbimi dhe mundësish. Duke vënë energjinë dhe pasionin tuaj në të, ai do t'ua shpërblejë atë njëqindfish.

Mirë se vini te ne, mirë se erdhët në shtëpinë tuaj!



**Stéphane Ganzer**

Këshilltar i Shtetit

Shefi i Departamentit të sigurisë, institucioneve dhe sportit.

# Të dashur banore të reja, të dashur banorë të rinj

Mirëpritja juaj në kantonin Valais është një ngjarje që ne dëshirojmë ta realizojmë duke ju informuar sa më mirë për shërbimet dhe programet që synojnë të lehtësojnë integrimin tuaj. Kantonin Valais kishte në fillim të vitit 2021, 349'311 banorë nga të cilët 23% me kombësi të huaj. Në kanton fliten dy gjuhë zyrtare, frëngjishtja në rajonin Valais Romand dhe gjermanishtja në rajonin Haut-Valais.

Qëllimi i politikës zvicerane të integritit është të forcojë kohezionin shoqëror në një frymë respekti dhe tolerance dhe të krijojë shanse të barabarta duke u dhënë mundësi të huajve të marrin pjesë në jetën shoqërore dhe kulturore.

Kjo broshurë mirësearchjeje ofron informacione mbi masat kryesore të integritit, tregon strukturat ku ju duhet të drejtoheni dhe organizatat përgjegjëse për projektet e integritit. Informimi mbi ofertat e integritit të zhvilluara në Valais sigurohet në radhë të parë nga delegatet dhe delegatët e integritit në komunën ose rajonin tuaj. Ato dhe ata janë partnerët tuaj për t'ju këshilluar dhe drejtuar në ambientin tuaj të ri. Mos ngurroni t'i kontaktoni!

## Informacione dhe kontakte


Për informacione lidhur me ofertat e integritit shoqëror dhe jetën e përditshme delegatet dhe delegatët e integritit të komunave janë në dispozicion :

→ [vs.ch/web/spm/integration#id17628967](https://vs.ch/web/spm/integration#id17628967)

Për informacione lidhur me projektet e integritit le Bureau cantonal d'intégration (BCI) (Zyra kantonale e integritit) ju jep ndihmë e këshilla :

→ [vs.ch/de/web/spm/integration](https://vs.ch/de/web/spm/integration)

Për informacione të veçanta, në faqet vijuese renditen hapat që duhen marrë, ofertat në dispozicion si dhe strukturat dhe organizmat që do të jenë në gjendje t'ju përgjigjen.



# Përmbledhje

<b>Hapat e parë</b>	<b>5</b>
<b>Kurse të gjuhës, përkthimi</b>	<b>6</b>
<b>Puna, njohja e diplomave</b>	<b>7</b>
<b>Parashkollimi, shkollimi, formimi i mëtejshëm</b>	<b>8</b>
<b>Shëndetësia, sigurimi shëndetësor</b>	<b>9</b>
<b>Sigurimet shoqërore</b>	<b>10</b>
<b>Jeta kulturore, shoqërore dhe sportive</b>	<b>12</b>
<b>Parandalim, këshillim dhe mbështetje</b>	<b>13</b>
<b>Informacione të tjera</b>	<b>14</b>

# Hapat e parë

## Regjistrimi në Kontrollin e banorëve

Sapo të mbërrini në kantonin Valais, ju duhet të paraqiteni në zyrën e kontrollit të banorëve të komunës suaj të banimit, brenda 14 ditëve nga mbërritja juaj dhe të kërkonte një leje qëndrimi.

Personat që vijnë në Zvicër nga l'UE/AELE (Bashkimi evropian/Bashkimi evropian i tregut të lirë) për të kërkuar punë mund të qëndrojnë në territorin e Zvicrës gjatë tre muajve të parë (qëndrim turistik).

## Llojet e lejeve të qëndrimit

Lejet e qëndrimit të marra të japin të drejtën për të jetuar legalisht në Zvicër. Ekzistojnë disa lloje lejesh qëndrimi që jepen në varësi të arsyes së mbërritjes dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin prej tyre janë të ndryshme:

Llojet e lejeve të qëndrimit:

- L leje afatshkurtër (më pak se një vit, e rinovueshme)
- B leje qëndrimi (1 vit ose 5 vjet, e rinovueshme)
- C leje qëndrimi (5 vjet, e rinovueshme)
- G leje pune për punëtorët ndërkufitarë.

Leje të veçanta në fushën e azilit:

- F për të huajt pranimit i përkohshëm (1 vit, e rinovueshme)
- N leje qëndrimi gjatë procedurës së këkesës për azil (3 deri në 6 muaj, e rinovueshme)

## Lidhja e një kontrate të sigurimit familjar dhe RC

Bëni një kontratë të sigurimit familjar dhe përgjegjësisë civile (zakonisht kërkohet nga pronarët)

## Bërja e një sigurimi shëndetësor

Bëni një regjistrim të detyrueshëm shëndetësor sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 3 muaj pas mbërritjes suaj. Sigurimi shëndetësor fillon në mënyrë prapavepruese që nga data e mbërritjes në Zvicër.

## Regjistrimi i fëmijës tuaj në shkollë

Regjistroni në shkollë fëmijën tuaj 4 vjeç ose më shumë (lindur para 01.08) duke shkuar pranë drejtorisë së shkollave të komunës.

Liste des communes du canton du Valais  
(Lista e komunave të kantonit Valais)

→ [vs.ch/fr/web/communes/commune](https://vs.ch/fr/web/communes/commune)

Service cantonal de la population et des migrations (Shërbimi kantonal i popullsisë dhe migracionit)

- Tél. 027 606 55 52
  - Avenue de la Gare 39, 1950 Sion
- [vs.ch/web/spm/entree-et-sejour](https://vs.ch/web/spm/entree-et-sejour)

Comparatif assurance ménage et responsabilité civile privée (Krahasimi i sigurimit familjar dhe përgjegjësisë civile)

→ [comparis.ch/hausrat-versicherung/default](https://comparis.ch/hausrat-versicherung/default)

Service cantonal de la santé publique (Shërbimi kantonal i shëndetit publik)

- Tél. 027 606 49 00
  - Av. de la Gare 23, 1950 Sion
- [vs.ch/sante](https://vs.ch/sante)

Comparatif d'assurance maladie (Krahasimi i sigurimeve shëndetësore)

→ [priminfo.admin.ch/fr/praemien](https://priminfo.admin.ch/fr/praemien)

Për më shumë informacion

→ [shikoni faqen 8](#)

Service cantonal de l'enseignement (Shërbimi kantonal i arsimit)

- Tél. 027 606 42 00
  - Place de la Planta 1, 1950 Sion
- [vs.ch/web/se](https://vs.ch/web/se)

Për më shumë informacion

→ [shikoni faqen 8](#)

# Kurse të gjuhës, përkthimi

## Mësimi i gjuhës vendase

Mësimi i gjuhës lokale është thelbësore për të qenë në gjendje të komunikojmë në të gjitha situatat e jetës së përditshme. Në të njëjtën kohë është një kusht i rëndësishëm për të gjetur një punë. Në kantonin Valais, në varësi të rajonit ku banoni, mësohet gjuha frënge ose gjermane. Në kurse mësohet gjermanishtja zyrtare, edhe pse dialekti përdoret në jetën e përditshme.

Kurse të shumta frëngjishteje e gjermanishteje propozohen për të sapoardhurit në të gjithë kantonin.



Tableau des cours d'allemand et de français  
(Tabela e kurseve të gjermanishtes dhe frëngjishtes)

→ [vs.ch/web/spm/integration](https://vs.ch/web/spm/integration)

## Përkthyesit e çertifikuar

Gjatë një takimi në kuadrin e shëndetit, të shkollës, të shërbimit social ose të ndonjë strukture tjetër, ju mund të thirrni një përkthyes të çertifikuar dhe të lidhur me organizma të njohura. Çdo rajon gjuhësor ka strukturën e vet të përkthimit.



AVIC, Français / Langues étrangères (AVIC, Frëngjisht / Gjuhë të huaja)

- Tél. 027 322 19 30
- Rue Oscar-Bider 60, 1950 Sion

→ [oseo-vs.ch/avic-action-valaisanne-pour-l-interpretariat-communautaire/](https://oseo-vs.ch/avic-action-valaisanne-pour-l-interpretariat-communautaire/)

FMO, Allemand / Langues étrangères (FMO, Gjermanisht / Gjuhë të huaja)

- Tél. 027 946 82 85
- Terbinerstrasse 3, 3930 Visp

→ [forum-migration.ch](https://forum-migration.ch)

# Puna, njohja e diplomave

## Autorizimet për punë

Le Service de la population et des migrations (SPM) (Shërbimi i popullsisë dhe migracionit) dhe le Service de l'industrie, du commerce et du travail (SICT) (Shërbimi i industrisë, tregtisë dhe punës) shqyrton dhe vendos për dhënien ose jo të lejeve të punës, pavarësisht nga kohëzgjatja e tyre.

Procedurat e marrjes së tyre janë të ndryshme, në varësi të shtetësisë së kërkuësve. Procedurat dhe formularët gjenden në faqen e internetit të SICT.

Qytetarët e l'UE/AELE (Bashkimit europian/ Bashkimit europian të tregut të lirë) mundën në parim të punojnë sapo të marrin dosjen nga autoritetet komunale të komunës së vendbanimit.

Për shtetasit e vendeve të treta, kushtet e marrjes gjenden në faqen e internetit të SICT.



Service de l'industrie, du commerce et du travail (Shërbimi i industrisë, tregtisë dhe punës)

- Tél. 027 606 73 10
  - Avenue du Midi 7, 1950 Sion
- [vs.ch/permisdetravail](https://vs.ch/permisdetravail)

## Njohja e diplomës

Ata që dëshirojnë të njohin diplomën e tyre duhet t'i drejtohen një organizmi certifikues për profesionet dhe diplomat e huaja. Vleftësimi i diplomave është federal. Të gjitha informacionet e nevojshme sigurohen nga Secrétariat d'Etat à la formation, à la recherche et à l'innovation (SEFRI). (Sekretariati i shtetit për formimin, kërkimin dhe rinovimin). Një faqe interneti është aktive në SEFRI për të ndërmarrë procedurat e njohjes.

Secrétariat d'Etat à la formation, à la recherche et à l'innovation (Sekretariati i shtetit për formimin, kërkimin dhe rinovimin)

- [sbfi.admin.ch/sbfi/fr/home/formation/reconnaissance-de-diplomes-etrange.html](https://sbfi.admin.ch/sbfi/fr/home/formation/reconnaissance-de-diplomes-etrange.html)

## Vlerësimi i njohurive

Nëse dëshironi të merrni një vlerësim të njohurive ose përvijës profesionale, duhet të drejtoheni te Service de la formation professionnelle (SFOP) (Shërbimi i formimit profesional) të kantonit.

Ky shërbim është gjithashtu përgjegjës për t'ju përgjigjur pyetjeve lidhur me formimin e të rinjve pas shkollimit të detyrueshëm dhe për të rriturit.

Service cantonal de la formation professionnelle (Shërbimi kantonal i formimit profesional)

- Tél. 027 606 42 50
  - Place de la Planta 3, 1950 Sion
- [vs.ch/web/ext-cant-adm-sfop-valform/validation-des-acquis-de-l-experience-vae](https://vs.ch/web/ext-cant-adm-sfop-valform/validation-des-acquis-de-l-experience-vae)

## Mbrojtja e punëtorëve

Në rast të një konflikti dhe mosrespektimi të kushteve të punës ose të pagës, duhet të drejtoheni te Service de protection des travailleurs et des relations du travail (SPT) (Shërbimi për mbrojtjen e punëtorëve dhe marrëdhënieve të punës). Ky shërbim kujdeset dhe respekton dispozitat ligjore në lidhje me punën dhe promovon shëndetin dhe sigurinë në punë.

Service de protection des travailleurs et des relations du travail (Shërbimi i mbrojtjes së punëtorëve dhe marrëdhënieve të punës)

- Tél. 027 606 74 00
  - Rue des Cèdres 5, 1950 Sion
- [vs.ch/web/spt](https://vs.ch/web/spt)

# Parashkollimi, shkollimi, formimi i mëtejshëm

## Oferta pritëse të kantonit

Kur mbërrini në kanton duhen kryer disa procedura në lidhje me fëmijët : marrja e një leje qëndrimi në rast bashkimi familjar, regjistrimi në shkollën e detyrueshme, kërkimi i një strukture pritëse për fëmijët, kërkesa për ndihma familjare tek punëdhënësi.

Para shkollimit të detyrueshëm, fëmija juaj nën moshën 4 vjeç mund të regjistrohet në një strukturë komunale që kujdeset për fëmijët e vegjël ose pranë kujdesit ditor familjar. Vëmendje e veçantë i kushtohet integritetit të fëmijëve të vegjël nga 0 në 4 vjeç, inkurajohet mësimi i gjuhës për të lehtësuar hyrjen e tyre në shkollë.

Shërbimi kantonal i rinisë mbikëqyr të gjitha ofertat e pritjes për fëmijë.



## Njohja e diplomës

Në Zvicër, shkolla është e detyrueshme për fëmijët nga 4 deri në 15 vjeç. Të gjithë fëmijët pa përjashtim pranohen në shkollat publike të kantonit Valais. Sapo të hyjnë në shkollë, nxënësit që vijnë nga jashtë do të kenë të drejtë, brenda kuadrit të shkollës, të ndjekin kurse intensive frëngjishteje ose gjermanishteje, në varësi të rajonit. Mësimi i gjuhës lokale në shkollë është i detyrueshëm dhe falas.

Pasi të jenë në shkollë, për nxënësit kujdesen para dhe pas shkollës, struktura komunale të përshtatshme, les Unités d'accueil pour les écoliers (UAPE). (Njësitë pritëse për nxënësit).

## Formimi jashtë shkollimit të detyrueshëm

Për të rinjtë që kanë përfunduar arsimin e tyre të detyrueshëm, l'Office cantonal d'orientation scolaire et professionnelle (OSP) (Zyra kantonale e orientimit shkollor e profesional) informon mbi mundësitë e ndryshme të formimit të mëtejshëm. Orientimi i propozuar synon t'u mundësojë të rinjve të realizojnë një projekt profesional përmes takimeve, këshillave dhe shërbimeve të informacionit. Ekzistojnë dy rrugë të formimit : studimet e gjimnazit dhe një rrugë e formimit profesional e bazuar në alternimin e teorisë në shkollë dhe praktikës në ndërmarrje.

Des classes d'accueil et d'intégration (SCAI) (Klasa të pritjes dhe integritetit) u propozojnë formime kalimtare të rinjve të një gjuhe të huaj, jashtë shkollimit të detyrueshëm dhe që dëshirojnë të vazhdojnë shkollën.

Service cantonal de la jeunesse (Shërbimi kantonal i rinisë)

- Tél. 027 606 48 20
  - Avenue Ritz 29, 1950 Sion
- [vs.ch/web/scj/secteur-d-accueil-a-la-journee](https://vs.ch/web/scj/secteur-d-accueil-a-la-journee)

Fédération valaisanne de l'accueil familial de jour (Federata valezane e pritjes ditore)

- [fvafj-vs.ch/federation/](https://fvafj-vs.ch/federation/)

Service cantonal de l'enseignement (Shërbimi kantonal i arsimit)

- Tél. 027 606 42 00
  - Place de la Planta 1, 1950 Sion
- [vs.ch/web/se](https://vs.ch/web/se)

Liste des structures d'accueil (Lista e strukturave pritëse)

- [vs.ch/web/scj/structures-d-accueil](https://vs.ch/web/scj/structures-d-accueil)

Office d'orientation scolaire et professionnelle (Zyra e orientimit shkollor e profesional)

- Tél. 027 606 45 00
  - Avenue de France 23, 1950 Sion
- [vs.ch/fr/web/osp](https://vs.ch/fr/web/osp)

Classes d'accueil et d'intégration (Klasat e pritjes dhe integritetit)

- [epasc.ch/fr/section-scai-81.html](https://epasc.ch/fr/section-scai-81.html)

Vue d'ensemble des voies de formation (Përmbledhje e rrugëve të formimit)

- [orientation.ch/dyn/show/2800](https://orientation.ch/dyn/show/2800)

# Shëndetësia, sigurimi shëndetësor

## Sigurimi shëndetësor bazë

Të gjithë personat që jetojnë në Zvicër përfitojnë nga kujdesi shëndetësor. Për këtë duhet bërë një sigurim shëndetësor bazë siç e kemi përmendur në hapat e parë. Sigurimi shëndetësor bazë mbulon një gamë të plotë përfitimesh. Është e mundur të bëni sigurime plotësuese, të padetyrueshme, shërbime shtesë. Këshillohet të gjeni shpejt një mjek të familjes dhe një pediatër për fëmijët tuaj.

Shërbimi kantonal i shëndetit publik ofron informacione për të gjitha çështjet lidhur me shëndetin. Në nivelin federal, një faqe interneti për barazinë e shanseve në lidhje me shëndetin, transmeton informacione të dobishme në 56 gjuhë.


Në kantonin Valais l'association Promotion santé Valais (PSV)(Shoqata e promovimit të shëndetit) ka si synim favorizimin sa më gjatë të shëndetit të popullsisë vlezane në tërësi në një prespektivë të mundësive të barabarta dhe këtë për të gjitha moshat.

## Ndihma për sigurimin shëndetësor

Për t'i mundësuar gjithë popullsisë të marrë përsipër pagesën e kësteve të sigurimit shëndetësor, konfederata dhe kantonet, japin me disa kushte ndihma që mundësojnë uljen e shumës së kësteve për njerëzit me të ardhura modeste. Në kantonin Valais duhet t'i drejtoheni à la Caisse de compensation (Fondit të Kompensimit).

## Telefoni i përhershëm

Nëse mjeku juaj i familjes nuk është i arritshëm dhe në rast urgjence, një sistem i përhershëm telefonik bën të mundur mobilizimin e mjeteve të ndihmës në rast urgjence vitale ose marrjen e përgjigjeve të pyetjeve tuaja në rast urgjence jo vitale. Këta numra janë të arritshëm 7 ditë mbi 7, 24 orë mbi 24.



Service de la santé publique (Shërbimi i shëndetit publik)

- Tél. 027 606 49 00
  - Avenue de la Gare 23, 1950 Sion
- [vs.ch/web/ssp](https://vs.ch/web/ssp)

Migesplus, portail pour l'égalité des chances en matière de santé (Migesplus, faqe interneti për barazinë e shanseve në lidhje me shëndetin)

→ [migesplus.ch](https://migesplus.ch)

Promotion santé Valais (Promovimi i shëndetit Valais)

→ [promotionsantevalais.ch/](https://promotionsantevalais.ch/)

Caisse de compensation du canton du Valais (Fondi i kompensimit të kantonit Valais)

- Tél. 027 324 91 11
  - Avenue Pratifiori 22, 1950 Sion
- [vs.ch/web/avs/reduction-de-prime-cm](https://vs.ch/web/avs/reduction-de-prime-cm)

Urgjenca vitale (për të rritur dhe fëmijë), qendra e alarmit)

- **144**

Uagjencat jovitale :

- Urgjencat pediatrike **0900 144 027**
- Urgjencat psikiatrike (Valais frankofone) **0800 012 210**
- Urgjencat për të rritur, mjeku roje **0900 144 033**
- Farmacia roje **0900 558 143**
- Dentisti roje **0900 558 143**

Helmimet

- **145**

Numra të tjerë urgjent

→ [shikoni faqen 14](#)

# Sigurimet shoqërore

---

## Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Sistemi zviceran i sigurimeve përfshin shumë sigurime shoqërore të detyrueshme, disa prej të cilave, më kryesoret ju paraqiten më poshtë. Përfitimet e ndihmës sociale mund të jepen nën disa kushte.

---

## Sigurimi i pleqërisë dhe të mbijetuarve (AVS, shtylla e 1-rë)

Sigurimet e shtyllës së parë janë të detyrueshme për të gjithë personat që jetojnë në Zvicër ose që ushtrojnë aty një aktivitet fitimprurës. AVS lejon që të gjithë njerëzit që banojnë në Zvicër (ose jashtë vendit, sipas rastit) të marrin një të ardhur bazë në momentin e pensionit, aktualisht 64 vjeç për gratë dhe 65 për burrat. Të gjithë personat që kryejnë një aktivitet profesional duhet të sigurohen që punëdhënësi i tyre i ka regjistruar në një fond kompensimi.

---

## Sigurimi i invaliditetit. (AI shtylla e 1 -rë)

Sigurimi i invaliditetit siguron personin në rast të paaftësisë për të fituar, për shkak të një aksidenti ose një sëmundjeje gjatë karrierës profesionale. Të huajt kanë të drejtë përfitimi nga AI nëse, gjatë ndodhjes së invaliditetit, banojnë dhe qëndrojnë zakonisht në Zvicër dhe nëse llogarisin të paktën një vit të plotë kontributesh ose dhjetë vjet qëndrimi të pandërprerë në Zvicër.

---

Caisse de compensation du Canton du Valais  
(Fondi i kompensimit të kantonit Valais)

- Avenue Pratifori 22
- 1950 Sion, Suisse
- Tél. 027/324 91 11

→ [vs.ch/web/avs](https://vs.ch/web/avs)

Office cantonal de l'assurance invalidité  
(Zyra kantonale e sigurimit të invaliditetit)

- Tél. 027 324 96 11
- Avenue de la Gare 15, 1950 Sion

→ [aivs.ch/](https://aivs.ch/)

---

## Sigurimi i aksidenteve (LAA)

Kushdo që ushtron një aktivitet profesional në Zvicër është i siguruar detyrisht sipas LAA kundër aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale. Nëse është i punësuar të paktën 8 orë në javë pranë të njëjtit punëdhënësi, është gjithashtu i siguruar kundër aksidenteve jo profesionale.

---

Caisse de compensation du Canton du Valais (Fondi i kompensimit të kantonit Valais)

- Avenue Pratifori 22
- 1950 Sion, Suisse
- Tél. 027/324 91 11

→ [vs.ch/web/avs](https://vs.ch/web/avs)

---

## Pensioni profesional (LPP, shtylla e 2-të)

Kontributet në një fond pensioni profesional janë një shtesë e pensionit AVS ose AI. Ato janë të detyrueshme për punonjësit, të ardhurat e të cilëve tejkalojnë një pagë minimale (21 510 franga / viti 2021). Të gjithë punëdhënësit duhet të sigurojnë stafin e tyre në institucionin e pensionit me të cilin janë lidhur.

---

## Sigurimi i papunësisë (AC)

Kushdo që punon në Zvicër dhe gjatë kësaj periudhe ka paguar sigurimin e papunësisë, ka në parim të drejtën e përfitimeve të papunësisë nëse humb punën e tij. Këto dëmshpërblime paguhen nën disa kushte të caktuara.

Sigurimi i papunësisë garanton të drejtën për një pagë në rast papunësie dhe inkurajon riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Ky sigurim është i detyrueshëm për punonjësit. L'Office régional de placement (ORP) (Zyra rajonale e vendosjes) e rajonit tuaj ju ofron këshilla, ju shoqëron dhe ju lehtëson në procesin e integritit tuaj në tregun e punës. Në kanton zhvillojnë aktivitetin e tyre disa ORP (Zyra rajonale të vendosjes).

---

Caisse cantonale de chômage  
(Fondi kantonal i papunësisë)

- Tél. 027 606 15 00
  - Place du Midi 40, 1950 Sion
- [vs.ch/web/cch](https://www.vs.ch/web/cch)

Office régional de placement  
(Zyra rajonale e vendosjes)

- [vs.ch/web/sict/offices-regionaux-de-placement](https://www.vs.ch/web/sict/offices-regionaux-de-placement)

Udhëzues, broshura dhe informacione plotësuese

- [vs.ch/web/sict/prestations-orp-demandeurs-emploi](https://www.vs.ch/web/sict/prestations-orp-demandeurs-emploi)

---

## Sigurimi shëndetësor

Kjo pikë është trajtuar te Shëndeti.

---

Sigurimi shëndetësor

- [shikoni faqen 8](#)

---

## Leje pas lindjes

Gratë e punësuar, të vetëpunësuar, ose të papuna kanë të drejtë për një pushim pas lindjes, të paguar për 14 javë. Që nga 1.1.2021 ka dhe një leje atësie të paguar për 2 javë.

---

## Shtesat familjare

Këto shtesa konsistojnë në një mbështetje financiare për çdo fëmijë dhe të ri që jeton në Zvicër, prindërit e të cilit janë të punësuar, të vetëpunësuar ose pa aktivitet fitimprurës. La Caisse de compensation (Fondi i kompensimit) është kontakti kryesor përsa i përket sigurimeve shoqërore aktuale.

---

Caisse de compensation du canton du Valais (Fondi i kompensimit të kantonit Valais)

- Tél. 027 324 91 11
  - Avenue Pratifiori 22, 1950 Sion
- [vs.ch/web/avs](https://www.vs.ch/web/avs)

---

## Ndihma sociale

Ndihma sociale ka për qëllim të ndihmojë njerëzit me vështirësi sociale ose financiare. Le Service de l'action sociale (SAS) (Shërbimi i aksionit social) është i ngarkuar për këtë. Në çdo komunë ose grup komunash, një Centre médico-social (CMS) (Qendër mjekësore-sociale) ofron këshilla dhe mbështetje për njerëzit në vështirësi.

---

Service cantonal de l'action sociale  
(Shërbimi kantonal i aksionit social)

- Tél. 027 606 48 00
  - Avenue de la Gare 23, 1950 Sion
- [vs.ch/web/sas](https://www.vs.ch/web/sas)

Lidhja me CMS të komunës ose rajonit tuaj

- [cms-smz.ch/](https://www.cms-smz.ch/)

# Jeta kulturore, sociale dhe sportive

## Aktivite kulturore

Jeta kulturore në kanton është e pasur dhe e larmishme. Ju mund të njiheni me ofertën kulturore në faqen e internetit të Culture Valais (Kulturë Valais), ku prezantohen institucionet kulturore si dhe kalendari i të gjitha manifestimeve në Valais.

Shumë komuna propozojnë një « Pass Bienvenue » (Paketë Mirëseardhjeje) që u krijon mundësinë personave të sapoardhur, të përfitojnë për një periudhë të kufizuar një hyrje të lirë në aktivitetet kulturore. Për informacione të sakta kontaktoni komunën tuaj të banimit.

Shërbimi kantonal i kulturës së kantonit mbështet aktivitetet kulturore. Ai favorizon hyrjen e secilit person në institucionet kulturore, mediateka dhe muze, si edhe në bibliotekat komunale e shkollore. Në shumicën e komunave, një mediatekë ose bibliotekë është falas për publikun.



## Aktivite të integrimit social

Kantoni Valais propozon shumë oferta në fushën e aktiviteve të integrimit shoqëror. Deletat dhe delegatët e integrimit mund t'ju informojnë për projektet e integrimit për shembull festat ndërkulturore, aktivitetet për të zbuluar mjedisin tuaj të ri, aktivitetet e komuniteteve etj.

## Aktivite sportive

Në kanton mund të praktikohen shumë aktivite sportive.

Një numër i madh klubesh, grupimesh të shoqatave sportive ofrojnë gjithë informacionet e nevojshme në faqen e tyre të internetit.

Informacione shtesë në lidhje me sportin për fëmijë dhe të rinj, programin rinia dhe sporti, fondin e sportit, si edhe koordinatat e shoqatave sportive kantonale etj, mund të merren direkt pranë Zyrës kantonale të sportit.

## Dëfrimet

Falë konfigurimit të tij gjeografik, kanton ofron një mori mundësish përsa i përket kohës së lirë. Komunitat ofrojnë informacione mbi aktivitetet e mundshme.

### Service de la culture (Shërbimi i kulturës)

- Tél. 027 606 45 60
  - Rue de Lausanne 45, 1950 Sion
- [vs.ch/web/culture](http://vs.ch/web/culture)

### Bibliothèques et médiathèques (Bibliotekat dhe mediatekat)

→ [bibliovalais.ch](http://bibliovalais.ch)

### Culture Valais

→ [culturevalais.ch/de](http://culturevalais.ch/de)

### Musées cantonaux du Valais (Muzetë kantonale të Valais)

→ [musees-valais.ch](http://musees-valais.ch)

### Déléguées et délégués à l'intégration (Deletatet dhe delegatët e integrimit)

→ [vs.ch/web/spm/integration#id17628967](http://vs.ch/web/spm/integration#id17628967)

### Office cantonal du sport (Zyra kantonale e sportit)

- Tél. 027 606 52 40
  - Rue des Casernes 42, 1950 Sion
- [ojs@admin.vs.ch](mailto:ojs@admin.vs.ch)
- [vs.ch/web/ocs](http://vs.ch/web/ocs)

### Valais tourisme (Valais turizëm)

→ [valais.ch/en/home](http://valais.ch/en/home)

# Parandalim, këshillim dhe mbështetje

---

## Barazia gjinore

E drejta për barazi midis grave e burrave garantohet nga Kushtetuta Federale e Zvicrës. Ligji garanton barazinë në të drejta dhe në fakte, veçanërisht në fushat e familjes, arsimit dhe punës. Ligji zviceran dënon në të njëjtën kohë dhunën brenda familjes. Zyra kantonale e barazisë dhe familjes në Valais është përgjegjëse për promovimin e barazisë mes grave e burrave, mbështetjen e familjes dhe luftën kundër dhunës familjare.

---

Office cantonale de l'égalité et de la famille  
(Zyra kantonale e barazisë dhe familjes)

- Tél. 027 606 21 20
  - Avenue de la Gare 33, 1951 Sion
- [egalite-famille.ch](http://egalite-famille.ch)

---

## Ndihmë për viktimat

Qendrat e konsultimit LAVI që synojnë të ndihmojnë viktimat, janë ngritur në qytete të ndryshme të kantonit dhe ofrojnë mbështetje dhe shoqërim, veçanërisht në rast dhune. Kushdo që ka pësuar një sulm të drejtëpërdrejtë në integritetin e tij fizik, psikologjik ose seksual, mund t'i drejtohet një qendre konsultimi.

---

Centre de consultation LAVI  
(Qendër konsultimi LAVI)

→ [violences-domestiques.ch](http://violences-domestiques.ch)

---

## Shëndeti seksual

Qendrat SIPE përmbushin mandatet kantonale në fushat e mëposhtme : shëndeti seksual, shtatëzania dhe lindja e parakohshme, konsultimi për çiftin dhe edukimi në shëndetin seksual.

---

Centres SIPE  
(Qendrat SIPE)

→ [sipe-vs.ch](http://sipe-vs.ch)

---

## Mbështetje kundër diskriminimeve

Sipas Kushtetutës federale, askush nuk mund të diskriminohet për shkak të origjinës së tij, racës, seksit, gjuhës, fesë ose mënyrës së tij të jetesës. Trajtimi i tyre i barabartë dhe mbrojtja e dinjitetit të tyre janë të garantuara për të gjithë ata që jetojnë në Zvicër.

Në nivelin kantonal çdokush që diskriminohet për shkak të origjinës ose racës së tij, mund të marrë këshilla dhe mbështetje të kualifikuar pranë Zyrës së dëgjimit kundër racizmit.

---

Bureau d'écoute contre le racisme  
(Zyra e dëgjimit kundër racizmit)

- Rue de Loèche 19, 1950 Sion
- [caritas-valais.ch/fr/bureau-ecoute-contre-racisme-329.html](http://caritas-valais.ch/fr/bureau-ecoute-contre-racisme-329.html)

---

Service de la population et des migrations  
(Shërbimi i popullsisë dhe migracionit)

→ [vs.ch/web/spm/protection-contre-les-discriminations](http://vs.ch/web/spm/protection-contre-les-discriminations)

# Informacione të tjera

Disa elemente të jetës praktike do të ndihmojnë vendosjen tuaj, veçanërisht kërkimi i një banese, përdorimi i mjeteve të transportit, informacionet mbi financat.

## Strehimi

Janë të nevojshme disa dokumente për të marrë një apartament si vërtetimi zyrtar i qëndrimit, një dokument i mungesës së ndjekjes penale, si dhe një sigurim i përgjegjësisë civile/ sigurimi i shtëpisë. Faqja i internetit e Association suisse des locataire (ASLOCA) (Shoqatës zvicerane të qiramarrësve) përfitëson këto informacione. Pronari mund të kërkojë një garanci qiraje.

Pas marrjes së banesës nëshkruhet një kontratë qiraje mes qiramarrësit dhe pronarit ose agjencisë.

Në rast vështirësie me pronarin ose agjencinë tuaj, ASLOCA ofron gjithashtu një ndihmë juridike dhe këshilla.

Association suisse des locataires  
(Shoqata zvicerane e qiramarrësve)

- Tél. 027 322 92 49
  - Rue de l'industrie 10, 1950 Sion
- [asloca.ch/valais](http://asloca.ch/valais)

## Taksa për radion dhe televizionin

Në Zvicër duhet të paguhen taksat e radios dhe televizionit. Kompania Serafe, pranë së cilës duhet të regjistroheni, është e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarife.

Société Serafe (Kompania Serafe)

→ [serafe.ch/de](http://serafe.ch/de)

## Transporti

Transportet publike në kantonin Valais sigurohen nga një rrjet i gjerë hekurudhor dhe autobusësh. Ju mund të merrni informacione mbi abonime të ndryshme si dhe një plan të detajuar oraresh, në të gjithë Zvicrën, pranë sporteve të stacioneve të trenit ose në faqen e internetit të hekurudhave federale (CFF) ose të autobusit të postës.

CFF (Hekurudhat federale)

→ [sbb.ch/en](http://sbb.ch/en)

PostAuto

→ [postauto.ch/en](http://postauto.ch/en)



## Lejet e qarkullimit të automjeteve

Personat që kanë një patentë të huaj drejtimi kanë një afat prej 12 muajsh, që nga mbërritja e tyre, për të shkëmbyer lejen e huaj me një dokument zviceran duke ju drejtuar Shërbimit kantonal të qarkullimit rrugor dhe lundrimit. Të gjitha informacionet e nevojshme do t'i gjeni në faqen e internetit të këtij shërbimi.

Service cantonal de la circulation routière  
et de la navigation  
(Shërbimi kantonal i qarkullimit rrugor dhe lundrimit)


→ [vs.ch/web/scn](http://vs.ch/web/scn)

---

## Mjedisi

Mjedisi juaj i jetesës është një dhuratë e çmuar që secili përpiqet ta mirëmbajë. Zhvillimi i qëndrueshëm është në qendër të propozimeve që sjellin komunat për projektet e zhvillimit, edukimit për mjedisin dhe trajtimin e mbeturinave. Në të gjitha komunat informacionet mbi këtë temë janë në dispozicion.

Në Zvicër, shumë lloje mbeturinash mblidhen ndaras nga secili dhe pastaj vendosen në kantonierë të ndryshëm. Për materiale të mëdha që s'mund të hidhen me mbeturinat shtëpiake, qendra të veçanta janë në dispozicion.



---

Site d'information pour le triage

(Faqja e informacionit për seleksionim)

→ [taxe-au-sac-valais.ch](https://taxe-au-sac-valais.ch)

---

## Financat, taksat

Në parim çdo i rritur mund të hapë një llogari bankare në Zvicër, duke paraqitur një dokument zyrtar identiteti. Mund të kërkohet gjithashtu një leje qëndrimi ose një vërtetim vendbanimi.

Kushdo që jeton ose ka një burim të ardhurash në kantonin Valais, duhet të paguajë taksa në përputhje me pagën dhe pasurinë e tij. Personat që kanë një leje qëndrimi C (Permis C) dhe shtetasit zviceranë duhet të plotësojnë çdo vit një deklaratë tatimore dhe ta paraqesin te autoritetet kompetente. Për personat që kanë leje qëndrimi L dhe B taksat zbriten direkt nga paga.

---

Service cantonal des contributions

(Shërbimi kantonial i kontributeve)

- Tél. 027 606 24 50
- Avenue de la Gare 35, 1950 Sion

→ [vs.ch/web/scc](https://vs.ch/web/scc)

---

## Numra telefoni të urgjencës

- Zjarri **118**
- Policia **117**
- Informacione telefonike **1811 ose 1818**

---

Telefoni i përhershëm

→ [shikoni faqen 8](#)

---

## Ky udhëzues është në dispozicion në gjuhët:

- anglisht
- arabisht
- fëngjisht
- gjermanisht
- italisht
- portugalisht
- serbisht
- shqip
- spanjisht

---

### Bureau cantonal de l'intégration

- Avenue de la Gare 39, 1950 Sion
  - Tél. 027 606 55 85
  - Tél. 027 606 55 59
- [vs.ch/web/spm/integration](https://vs.ch/web/spm/integration)



---

### Impressum

Përpilimi:      État du Valais, 2025  
Design:           Forme  
Fotografitë:     Valais/Wallis Promotion,  
                      État du Valais, Unsplash,  
                      Interpret